URDHËR
Nr.9767, datë 13.12.2016

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, të nenit 22, pika 3 të ligjit nr.44/2015, datë 28.5.2015, "Kodi i Procedurave Administrative", të nenit 11, pika 2 të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, të kreut VII, nenit 56 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Sekretarit të Përgjithshëm Z.Gentian Këri, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike.
2. Kompetencat e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, do të ushtrohen nga Sektretari i Përgjithshëm nga data 13.12.2016 deri më 31.12.2017.
3. Vendimi nr.5813, datë 15.07.2016 "Për delegim kompetence" dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë urdhër shfuqizohet.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Milva Ekonomi